



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 196, datë 22.09.2021

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
KRYESOR TË SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SH.P.K., NËPËRMJET SHITJES
SË 100% TË KUOTAVE TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 6.2, të “Kushteve të Licencës së Veprimtarisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; pikës 5.2, të “Kushteve të Licencës së Veprimtarisë së Tregtimit të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 122/2 prot., datë 15.09.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 110, datë 22.12.2010, i ndryshuar, si dhe licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit nr. 109, datë 22.10.2010.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838 prot., datë 21.07.2021, shoqëria ka kërkuar nga ERE autorizimin për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 838/2 prot., datë 18.08.2021 dhe nr. 838/4 prot., datë 30.08.2021, shoqëria ka depozituar në ERE sqarime dhe dokumentacion shtesë.

- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të pikës 6.2, të “Kushteve të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” dhe pikës 5.2, të “Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike”,
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 184, datë 10.09.2021, vendosi shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave me 30 ditë, me qëllim vendosjen e komunikimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe marrjen e informacionit përkatës për fazën në të cilën ndodhet dhënia e miratimit për këtë transferim nga MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838/5 prot., datë 10.09.2021, shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k. ka depozituar një kopje të shkresës së MIE-s nr. 5792/2 prot., datë 07.09.2021, me anë të së cilës, MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka miratuar transferimin e pjesëve të kapitalit të shoqërisë koncesionare “ENERGY PLUS” sh.p.k..
- Shoqëria ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.
- Autorizimi nga ERE jepet (duke vlerësuar edhe miratimin/qëndrimin e Autoritetit Kontraktor), me kushtin që shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k., të ruajë emrin me të cilin është licencuar, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në licencën për prodhimin e energjisë elektrike dhe licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me të cilat është pajisur.
- Në çdo rast, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.
- Në zbatim të nenit 20, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në kuadër të dhënies së informacionit nga të licencuarit, shoqëria të njoftojë ERE-n pasi të bëhet efektiv ky transferim kuotash, sipas këtij autorizimi të dhënë nga ERE.
- Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k., ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj.

2. Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
3. Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI